

**MIRELA NOFULLA**

**VËSHTRIM ANALITIK MBI PROCESIN E VENDOSJES  
SË MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE MES SHQIPËRISË  
DHE SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS  
(1922-1926)**

Kontakti i emigrantëve shqiptarë me “botën e re” në fund të shek. XIX, shënon fillesat e miqësisë midis popullit shqiptar dhe atij amerikan, e cila konkretizohet në vitin 1922 me njohjen e qeverisë shqiptare nga SHBA dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis dy shteteve. Kjo ishte një kurorëzim i përpjekjeve, sakrificave, investimeve morale dhe materiale të personaliteteve, shoqërive, organizatave shqiptare dhe amerikane si dhe të vullnetit të mirë të qeverive respektive. Të gjithë këta komponentë nuk do të kishin kuptim jashtë sfondit historik të kësaj periudhe.

Ishte Lufta e Parë Botërore ajo që i nxiti këto përpjekje, të cilat sinkronizoheshin me rrethanat e krijuara. SHBA e fuqizuar mirë ekonomikisht, me përfshirjen në luftë në vitin 1917, theu parimin e izolacionit, “shkeli” amanetin e Xh. Uashingtonit (G. Washington) dhe T. Xhefersonit (T. Jeferson) dhe kapërceu mentalitetin neutral amerikan. Ky angazhim ishte një ndryshim rrënjësor në historinë e saj, por ishte gjithashtu një kryqëzatë për liritë universale e bërë në emër të popujve<sup>1</sup>. Kontributi amerikan në fitoren e Luftës së Parë Botërore i dha peshën kryesore në vendimmarrjen politike, që do të pasojë përfundimin e Luftës.

Është diaspora shqiptare e Amerikës ajo që e përthithi e para situatën dhe, me futjen e Amerikës në luftë, më shumë se 3000 vullnetarë nga diaspora shqiptare u bënë pjesë e trupave ushtarake amerikane<sup>2</sup>. Për shqiptarët e Amerikës, ky ishte një shans historik për të shprehur mirënjohjen e tyre për mikpritjen amerikane, si dhe për të fituar simpatinë e shtetit dhe popullit amerikan.

<sup>1</sup> Henry Kissinger, *Diplomacia*, Tiranë: “Laert”, 1999, f. 48.

<sup>2</sup> Beqir Meta, *Federata Panshqiptare “Vatra”*, Tiranë: “Globus”, 2002, f. 139.

Megjithëse në nëntor të vitit 1918, Lufta e Parë Botërore mbaroi, Shqipëria vazhdonte të ishte e pushtuar dhe pa qeverisje qendrore. Tabloja që ajo ofronte, dekonspirimi nga bolshevikët i Traktatit të Fshehtë të Londrës dhe Konferenca e Paqes në horizont, alarmoi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare pasi rrezikoheshin jo vetëm kufijtë e Shqipërisë, por edhe pavarësia e saj. Në fund të dhjetorit 1918 u mbledh Kongresi i Durrësit, prej të cilit doli qeveria shqiptare me në krye Turhan Pashë Përmetin. Gjithashtu Kongresi caktoi delegacionin zyrtar të kryesuar nga kryeministri Përmeti<sup>3</sup>. Këtij delegacioni fati historik i ngarkoi mbrojtjen e kërkesave shqiptare në tryezën diplomatike të Konferencës së Paqes, e cila kishte për qëllim zgjidhjen e problemeve që solli konflikti botëror. Prania e SHBA në Konferencën e Paqes të mbledhur në Paris më 18 janar 1919, si mbështetëse e parimit të vetëvendosjes së popujve, ishte një shpresë e madhe për popullin shqiptar dhe të gjithë popujt e tjerë të vegjël e pa përkrahje si ai.

Ndërkohë që Konferenca e Paqes vazhdonte punimet, çështja shqiptare u bë pjesë e “çështjes së Adriatikut”. Më 29 korrik 1919 nënshkruhet marrëveshja Titoni (Tommaso Tittoni)-Venizelos (Eleferios Venizelos). Sipas saj Roma do të mbështeste kërkesat greke për rivendikim të kufijve me Shqipërinë, ndërsa Greqia do të njihte aneksimin e Vlorës nga Italia dhe protektoratin italian mbi shtetin e cunguar shqiptar<sup>4</sup>. Ky fakt shqetësoi shumë shqiptarët. Në këto rrethana kryetari i delegacionit zyrtar shqiptar në Paris, Luigj Bumçi\* shprehej se Shqipërinë e kërcënonte rreziku i copëtimit nga marrëveshja italo-greke dhe se shpresa e vetme ishte SHBA<sup>5</sup>. Në këto rrethana, orientimi drejt SHBA ishte nevojë dhe domosdoshmëri jetike, pasi së pari SHBA u përfshinë në konfliktin e përgjakshëm në emër të lirive universale, por gjithashtu SHBA nuk kishin interesa politike apo territoriale në Shqipëri dhe nuk ishin të përfshira në Traktatin e Fshehtë të Londrës të 1915-ës.

<sup>3</sup> Arben Puto, *Shqipëria Politike, 1912-1939*, Tiranë: “Toena”, 2009, f. 221.

<sup>4</sup> Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare*, Tiranë: “Albin”, 2003, f. 312.

\* Luigj Bumçi kryesonte delegacionin zyrtar shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris që nga qershori 1919.

<sup>5</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: AMPJ), viti (më tej: V.) 1919, dosja (më tej: D.) 19, fl. 16, Telegram i kryetarit të delegacionit shqiptar në Paris, Bumçi, dërguar Federatës “Vatra”, 18 gusht 1919.

Më 23 shtator 1919 delegacioni i qeverisë së Durrësit në Konferencën e Paqes, i shkruante organizatave shqiptare në SHBA “Vatra” dhe “Partia Politike”, se “vepra më e vlefshme e tyre në dobi të Atdheut do të ishte përpjekja për të tërhequr simpatinë e popullit dhe qeverisë amerikane ndaj kombit shqiptar”<sup>6</sup>. Diasporës shqiptare i kërkohet nga delegacioni zyrtar shqiptar në Konferencën e Paqes, të përpiqej për sigurimin e përkrahjes së qeverisë dhe popullit amerikan për Atdheun e tyre natyral. Duke qenë pjesë e realitetit amerikan diaspora shqiptare kishte mundësi më të mira për të lobuar dhe punuar në dobi të sigurimit të mbështetjes amerikane për çështjen shqiptare. Por këto përpjekje, në të cilat u angazhuan shqiptarë dhe shqiptarofilë, duke mos pasur karakter zyrtar rrezikoheshin të mos merreshin seriozisht nga Shtetet e Bashkuara. Në letrën e 24 shtatorit 1919 drejtuar kryetarit të delegacionit zyrtar shqiptar në Konferencën e Paqes L. Bumçit, vatrani Kostë Çekrezi shkruante : *“Shokët e mi dhe unë nuk kemi asnjë karakter zyrtar dhe është shumë zor për neve që të piqemi me zyrtarë të lartë të qeverisë pa qenë zyrtarë. Përfaqësorja duhet të ish këtu porsa u formua qeveria, ky është mendimi i përgjithshëm i tërë shqiptarëve të cilët po habiten dhe nuk gjejnë dot asnjë shpjegim për këtë moskujdesje kaqë të dëmshme*<sup>7</sup>. Lindte nevoja e një përfaqësuesi zyrtar pranë autoriteteve amerikane. Diaspora shqiptare në SHBA, i tërhiqte vëmendjen kryetarit të delegacionit zyrtar në Konferencën e Paqes Imzot Bumçit se, moskujdesja për praninë e përfaqësuesit zyrtar në SHBA ishte e dëmshme. Diaspora shqiptare në SHBA, e cila njihte potencialin e kësaj fuqie, në momentet që kalonte Shqipëria e çështja shqiptare, lidhte tek SHBA shpresat e vendit të vet të vogël, pa mbështetje dhe të rrezikuar nga copëtimi.

Në përgjigje të letrës së sipërpërmendur, L. Bumçi më 8 tetor 1919 i shkruante K. Çekrezit, se qeveria shqiptare po përpiquej, por ishte e vështirë të gjendej “njeriu i nevojshëm për këtë punë”<sup>8</sup>. Sipas studiuesit Beqir Meta qëndrimi i qeverisë së Durrësit në lidhje me caktimin e një përfaqësuesi “ngjante më tepër me një hezitim ndoshta të shkaktuar nga

---

<sup>6</sup> AMPJ, V. 1919, D. 19, fl. 30, Letër e delegacionit zyrtar shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris drejtuar “Vatrës” dhe “Partisë Politike”, 23 shtator 1919.

<sup>7</sup> Po aty, V. 1919, D. 19, fl. 37, Letër e K. Çekrezit drejtuar kryetarit të delegacionit shqiptar në Paris, L. Bumçit, 24 shtator 1919.

<sup>8</sup> Po aty, fl. 46, Letër e kryetarit të delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes, L. Bumçi dërguar K. Çekrezit, 8 tetor 1919.

presioni i qeverisë italiane”<sup>9</sup>. Qeveria italiane nuk mund të pajtohej me një afrim të Shqipërisë me SHBA, presidenti i së cilës me programin e tij të 14 pikave<sup>10</sup>, kishte sjellë një frymë krejtësisht të re dhe të panjohur në marrëdhëniet ndërkombëtare të Evropës të bazuara historikisht tek lufta dhe diplomacia e fshehtë në kurriz të popujve. Megjithatë edhe vështirësia për gjetjen e njeriut të përshtatshëm për këtë mision deri diku ishte një justifikim i drejtë.

Hapësira që krijoi telegrami i datës 8 tetor 1919 i dha mundësi “Vatrës” që më 19 tetor 1919 të propozonte kandidaturën e saj, K. Çekrezi për të përfaqësuar zyrtarisht Shqipërinë në SHBA<sup>11</sup>. Po kush ishte Kostë Çekrezi? Ai ishte lindur më 31 mars 1892 në fshatin Ziçisht të Korçës. Pasi kreu gjimnazin në Korçë, për një vit (1910-1911), ndoqi studimet për drejtësi në Selanik. Më pas Çekrezi punoi si sekretar i Gjykatores Civile të Vlorës dhe më tej si sekretar-përkthyes i Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit. Në tetor të 1914-ës emigroi në SHBA, i thirrur nga “Vatra” për të drejtuar gazetën “Dielli”. Më 1918 diplomohet në Universitetin e Harvardit.

Ndërkohë Konferenca e Paqes vazhdonte punimet. Pas memorandumit të 9 dhjetorit 1919<sup>12</sup>, të cilin e nënshkroi dhe SHBA, më 13 janar 1920 nënshkruhet marrëveshja midis Italisë, Francës dhe Britanisë, por pa dijeninë e Amerikës. Marrëveshja e 13 janarit 1920 materializoi Traktatin e Fshehtë të Londrës, duke e copëtuar Shqipërinë midis Italisë, Greqisë dhe Jugosllavisë<sup>13</sup>. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje ishte ekzekutim i asgjësimit të shtetit të pavarur shqiptar. Këto plane alarmuan dhe

<sup>9</sup> B. Meta, *Federata Panshqiptare...*, f. 252.

<sup>10</sup> Program i presidentit amerikan Uillson i quajtur 14 pikat, të cilat mishëronin parime të marrëdhënieve ndërkombëtare që kishin të bënin me diplomacinë e hapur, vetëvendosjen, rregullimin e çështjes së kolonive, krijimin e Lidhjes së Kombeve, lirinë e lundrimit, barazinë në tregtinë ndërkombëtare, kufizimin e armatimit etj.

<sup>11</sup> *AMPJ*, V. 1919, D. 19, fl. 55, Telegram i shoqërisë “Vatra” dërguar L. Bumçit, 19 tetor 1919.

<sup>12</sup> Më 9 dhjetor 1919 trojka e përfaqësuesve anglo-franko-amerikan nënshkroi një memorandum, i cili realizonte qëllimet italiane në lidhje me sovranitetin mbi Vlorën dhe hiterlandin e saj dhe protektoratin mbi Shqipërinë, por nga ky memorandum përfitonte dhe Greqia pasi lihej e hapur çështja e kufijve jugorë dhe parashikohej që ai të ishte objekt i bisedimeve të mëtejshme. Ndërsa shtetit serbo-kroato-sllloven i njihej e drejta të ndërtonte dhe shfrytëzonte vija hekurudhore në Shqipërinë e Veriut.

<sup>13</sup> A. Puto, *Historia diplomatike ...*, f. 318.

amplifikuan Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Në janar të vitit 1920 u mblodh Kongresi i Lushnjës, i cili rrëzoi qeverinë e Durrësit të cilësuar si antikombëtare dhe proitaliane dhe krijoi qeverinë e re kombëtare të kryesuar nga Sulejman Delvina. Të zhgënjyer nga diplomacia evropiane përballë një rreziku evident, shqiptarët ishin të vendosur për “ruajtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë si dhe për mos pranimin e asnjë lloj protektorati të huaj”<sup>14</sup>. Ky qëndrim nëpërmjet një telegrami iu përcoll Senatit Amerikan. Në telegramin dërguar Senatit Amerikan shkruhej “...sot i bëjmë thirrje zemrave të senatit duke lutur të marrin masat dhe hapat e nevojshëm për të shpëtuar Shqipërinë nga pretendimet imperialistike të shteteve fqinjë dhe për të ndaluar fuqitë e mëdha të Evropës të venë në zbatim traktatin e Londrës të vitit 1915. Kombi Shqiptar beson me besim të patundur se kombi amerikan duke respektuar parimet e drejtësisë dhe të njerëzimit do ti sigurojë Shqipërisë një pavarësi të plotë së bashku me integritetin tokësor”<sup>15</sup>. SHBA ishte shpresa e madhe e shqiptarëve për shmangien e rrezikut të copëtimit. Në një situatë të tillë, L. Bumçi njoftoi K. Çekrezin për emërimin e tij si përfaqësues zyrtar të delegacionit shqiptar në Paris.<sup>16</sup>

Por Kostë Çekrezi i bëri me dije Bumçit se përfaqësuesi zyrtar shqiptar nuk mund të emërohej nga një delegacion me fuqi të deleguar, por nga vetë qeveria shqiptare. Nga miqtë e tij në Departamentin e Shtetit, Çekrezit i ishte këshilluar se ky emërim ishte i parregullt dhe se duhej t’i jepej grada e komisarit prej qeverisë, pasi kjo ishte praktika që ndiqej nga qeveritë e panjohura, megjithëse dhe vetë grada e komisarit nuk gjente vend në hierarkinë e titujve diplomatikë amerikanë<sup>17</sup>.

Kundërshtimi i Uillsonit (Willson) ndaj projekteve të Aleatëve europianë për zgjidhjen e “çështjes së Adriatikut”, për K. Çekrezin ishte një rast që duhej shfrytëzuar me çdo kusht. Për të ishte koha e zbritur nga qielli për të ngritur zërin, për të përhapur lajme dhe dhënë intervista për

<sup>14</sup> Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë, 1912-2000*, Tiranë: “Kristalina-KH”, 2007, f.112.

<sup>15</sup> *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), F. 30, V. 1920, D. 23, fl. 1, Telegram i Kongresit kombëtar të Shqipërisë drejtuar Senatit amerikan.

<sup>16</sup> *AMPJ*, V. 1920, D. 31, fl. 5, Letër e K. Çekrezit drejtuar kryetarit të delegacionit shqiptar në Paris L.Bumçit, 19 shkurt 1920.

<sup>17</sup> *Po aty*.

Shqipërinë<sup>18</sup>. Frika se nuk do të realizonte dot misionin dhe rrezikimi i Shqipërisë nga zgjidhja evropiane e “Çështjes së Adriatikut”, e shtynë Çekrezin të paraqitej fill pas Kongresit të Lushnjës si përfaqësues zyrtar i Shqipërisë pa emërim. Agjencia e lajmeve “Associated Press” shkruante: “Duke qënë se Shtetet e Bashkuara s’e kanë njohur edhe Qeverin’ e Përtashme Shqiptare, dërgata e z.Chekrezit do të ketë për qëllim kryesisht që të sigurojë atë njojtje dhe t’a bënjë të njohur popullin dhe qeverin’ e Amerikës me fazat e ndryshme të problemit shqiptar në lidhje me çështjen e shumëbiseduar t’Adriatikut, si edhe me meritat instiktive të çështjes së Shqipërisë, kështu thotë z.Chekrezi”<sup>19</sup>. “Associated Press” bazuar në fjalët e K. Çekrezit sqaronte se kryetari i delegacionit zyrtar shqiptar në Konferencën e Paqes, Luigj Bumçi kishte vënë në dijeni dhe Departamentin e Shtetit, për emërimin e Çekrezit dhe ai nuk shfaqti kundërshtime. Ky deklaram e bënte emërimin e tij më dinjitoz dhe i siguronte një impakt pozitiv në qeverinë dhe opinionin amerikan, sa të nevojshëm aq dhe të domosdoshëm për funksionimin e këtij përfaqësimi.

Bazuar në modelin e praktikës së aplikuar nga çekoslllovakët dhe rumunët, Kostë Çekrezi i sugjeroi ministrit të Jashtëm shqiptar Mehmet Konica krijimin e një legate shqiptare në Uashington. Sipas tij legata, e cila nuk do të kushtonte më shumë se përfaqësia, do të ngrinte prestigjin e shtetit<sup>20</sup>. Rëndësinë e sugjerimeve që i bënte qeverisë shqiptare, Çekrezi e vinte në dukje me deklaratat e tilla si: “Sot posti i Washingtonit një post i klasit të parë”<sup>21</sup>. Më 18 mars 1920, atij i mbërrijnë kredencialet dhe dokumentet zyrtare, të futura në zarfin e letrës që mban datën 3 mars 1920 dërguar nga ministri Konica<sup>22</sup>, të nënshkruara nga kryeministri dhe ministri i Jashtëm shqiptar<sup>23</sup>.

Më 27 mars 1920 K. Çekrezi ia dorëzoi ato Sekretarit të Shtetit B. Kolbi (B. Colby), së bashku me kërkesën për njohjen e pavarësisë së

<sup>18</sup> Po aty.

<sup>19</sup> Po aty.

<sup>20</sup> Po aty, fl. 17, Letër e K. Çekrezit drejtuar ministrit të Jashtëm, M. Konica, 5 mars 1920.

<sup>21</sup> Po aty, fl. 29, Letër e K. Çekrezit drejtuar ministrit të Jashtëm, M. Konica, 15 mars 1920.

<sup>22</sup> Po aty, fl. 41, Letër e K. Çekrezit drejtuar ministrit të Jashtëm, M. Konica, 20 mars 1920.

<sup>23</sup> Muin Çami, “Vendosja e marrëdhënieve diplomatike Shqipëri-ShBA”, *Përpyekja*, Nr. 9-12 (Nr.special), Tiranë: 1997, f. 115.

Shqipërisë<sup>24</sup>. Duke iu referuar memorandumit të 9 dhjetorit 1919, Çekrezi vinte në dukje se SHBA e kishin njohur në parim pavarësinë e Shqipërisë. Kërkesën për njohjen de jure të qeverisë së Shqipërisë dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike shqiptaro-amerikane ai e bazonte në efektet pozitive që do të kishin ato në klimën politike të Ballkanit<sup>25</sup>. Pas dorëzimit të kredencialeve, Sekretari i Shtetit nuk iu drejtua më “Mr. Çekrezi” (zoti Çekrezi) si në fillim, por “Mr. Commissioner” (I dërguar Çekrezi)<sup>26</sup>. Ky ishte fillimi i shpresave të mëdha për njohjen e qeverisë shqiptare nga SHBA dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve. Por do të rrjedhë shumë kohë deri në vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve, të cilat do sjellin përfaqësuesin diplomatik të Shqipërisë në Uashington.

Më 7 prill 1920 Çekrezi pati takimin e dytë me Sekretarin e Shtetit, Kolbi. Në këtë takim ai “shtroi me këmbëngulje çështjen e njohjes së qeverisë shqiptare duke e argumentuar me ndikimin që kishte ajo në përmirësimin e gjendjes në Shqipëri, konsolidimin e shtetit shqiptar, forcimin e qeverisë së Tiranës si dhe me nevojën për të kundërbalancuar efektet shumë negative të qëndrimit të trupave italiane në Shqipëri. Këto të fundit jo vetëm po bllokoni përpjekjet e qeverisë shqiptare për organizimin e vendit, por po diskreditonin administratën shqiptare me synimin për të provuar se shqiptarët nuk ishin të aftë për vetëqeverim”<sup>27</sup>. Kolbi u shpreh se përgjigjja në lidhje me pranimin e një ministri shqiptar do të jepej shpejt. Por, K. Çekrezi, dyshues për këtë të fundit shprehej: “*it is too good to be true*”<sup>28</sup> (është shumë e mirë për të qenë e vërtetë). Ndërsa në takimin e tretë më 23 prill 1920, Sekretari amerikan i Shtetit lidhur me çështjen e njohjes së qeverisë u përgjigj se shqiptarët duhet të prisnin edhe pak kohë<sup>29</sup>.

<sup>24</sup> AMPJ, V. 1920, D. 31, fl. 43, Letër e K. Çekrezit drejtuar ministrit të Jashtëm M. Konicës, 27 mars 1920.

<sup>25</sup> B. Meta, *Federata Panshqiptare...*, f. 252.

<sup>26</sup> AMPJ, V. 1920, D. 31, fl. 43, Letër e K. Çekrezit drejtuar ministrit të Jashtëm M. Konicës, 27 mars 1920.

<sup>27</sup> B. Meta, *Federata Panshqiptare...*, f. 263.

<sup>28</sup> AMPJ, V. 1920, D. 31, fl. 54, Letër e K. Çekrezit drejtuar ministrit të Jashtëm, M. Konica, 7 prill 1920.

<sup>29</sup> *Po aty*, fl. 62, Letër e K. Çekrezit drejtuar ministrit të Jashtëm, M. Konica, 27 prill 1920.

Por zhvillimet e brendshme në Shqipëri bënë që qeveria shqiptare të mos priste gjatë. Ministri i Jashtëm, M. Konica, në letrën e datës 7 maj 1920 dërguar K. Çekrezit e informoi atë mbi përpjekjen e Esat Pashë Toptanit për marrjen e pushtetit me dhunë dhe e udhëzonte të ritakonte Sekretarin e Shtetit<sup>30</sup>. Çekrezi në pamundësi për t'u takuar me zotin Kolbi, bisedoi me asistentin e tij, dr. Albert Shau (Albert Shaw). Pasi i bëri me dije Shaut situatën në Shqipëri, u shpreh, "Këto ngatërime vijnë nga që qeveria jonë s'është e njohur nga nonjë anë"<sup>31</sup>. Hapur dhe qartë shprehej se e vetmja garanci për mospërsëritjen e situatave të tilla në Shqipëri ishte njohja e qeverisë shqiptare.

Kostë Çekrezi në bisedat me zyrtarët e Departamentit të Shtetit gjatë drekave dhe darkave informale kuptoi se njohja e qeverisë shqiptare nuk varej vetëm nga fakti i mosratifikimit të Traktatit të Paqes nga Kongresi Amerikan. Kishte dhe arsye që s'thuheshin zyrtarisht, të cilat kishin të bënin me mosnjohjen e duhur të Shqipërisë nga populli amerikan, dyshimin mbi stabilitetin e qeverisë shqiptare nga "nami i lig që kishin marrë shqiptarët për kryengritje dhe zihje civile, si dhe me njohjen jo të plotë mbi zhvillimet e brendshme dhe të jashtme të saj nga ana e Departamentit të Shtetit dhe e popullit amerikan"<sup>32</sup>.

Për të shmangur arsyet e mësipërme, Çekrezi u përkushtua aq shumë sa rrezikoi dhe shëndetin. Problemet me këtë të fundit, të shkaktuara nga lodhja dhe fakti që nuk po realizonte njohjen e qeverisë shqiptare nga SHBA, e detyruan K. Çekrezin të jepte dorëheqjen më 22 shtator 1920, por qeveria shqiptare nuk reagoi ndaj këtij akti<sup>33</sup>. Në këto kushte ai vazhdon punën. Më 7 tetor 1920, Çekrezi i dërgoi sërish një memorandum Departamentit të Shtetit, në të cilin kërkohet njohja e shtetit shqiptar. Këtë kërkesë ai e bazonte edhe në dëshirën e Shqipërisë për të vendosur marrëdhënie tregtare me SHBA<sup>34</sup>.

Përmirësimi i shëndetit, e nxiti Çekrezin që më 21 tetor 1920 t'i dërgonte një telegram ministrit të Jashtëm M. Konica, ku t'i shprehte

<sup>30</sup> *Po aty*, fl. 116, Letër e K.Çekrezit drejtuar ministrit të Jashtëm, M. Konica, 19 maj 1920.

<sup>31</sup> *Po aty*, fl. 116.

<sup>32</sup> *Po aty*, fl. 103, Letër e K. Çekrezit drejtuar ministrit të Jashtëm, M. Konica, 17 nëntor 1920.

<sup>33</sup> *Po aty*, fl. 103.

<sup>34</sup> B. Meta, *Federata Panshqiptare...*, f. 268-269.

dëshirën për të vazhduar detyrën<sup>35</sup>. Por vetëm dy ditë më pas, më 23 tetor 1920, qeveria e Sulejman Delvinës emëroi si komisar të saj në Amerikë, amerikanin shqiptarofil Telford Erikson (Telford Erickson)<sup>36</sup>. Kjo lëvizje diplomatike u bë për të nxitur lidhjen e marrëdhënieve diplomatike me ShBA. Mendohej se Eriksoni<sup>37</sup> do të ishte më produktiv, për shkak të përkushtimit, njohjes së realitetit shqiptar dhe njohjeve personale me personalitete të shumta politike me influencë në ShBA. Por ai nuk e kreu detyrën e ngarkuar nga qeveria shqiptare. Kjo e fundit sipas K. Çekrezit ishte pasojë e parimit, të qeverisë amerikane “që të mos pranonte qytetarët e saj si përfaqësues të një qeverie të huaj”<sup>38</sup>. Ilir Ikonomi është i mendimit se Eriksoni nuk e ushtroi funksionin e tij për arsye monetare, pasi një javë nga arritja e tij në Uashington, qeveria që e kishte emëruar atë ishte zëvendësuar nga kabineti i I. Vrionit dhe në kushtet e krizës politike, ai nuk duhet të priste fonde. Nga ana tjetër, Çekrezi nuk i dorëzoi as llogarinë dhe as zyrën<sup>39</sup>. Në logjikën e ngjarjeve, qeveria amerikane nuk kishte precedentë në njohjen e nënshtetasve të saj si përfaqësues zyrtar të një shteti tjetër. Ky rol mund t’i jepej vetëm një “konsulli nderi”, jo përfaqësuesi zyrtar të qeverisë shqiptare.

Situata e kontakteve zyrtare rëndohej edhe nga mungesa e fondeve nga ana e qeverisë shqiptare, madje këto të fundit kishin qenë mjaft problem edhe për Kostë Çekrezin. Gjatë gjithë korrespondencës së tij me ministrin e Jashtëm M. Konica, ai vazhdimisht shprehu nevojën për para, për sekretar, për makinë, për këshilltarë amerikanë me përvojë dhe influencë në Departamentin e Shtetit. Megjithëse i ndërgjegjshëm se qeveria shqiptare nuk mund t’ia siguronte ato, ai shpresonte dhe këshillonte qeverinë për hua nga “Vatra”, e cila potencialisht kishte mundësi, por që dhe konkretisht ajo bënte mjaft në këtë drejtim. Kështu K. Çekrezi në një raport dërguar ministrit Konica shkruante: “*Në këshillin e Vatrës, në mbledhje u vendos që të më jepeshin 750\$ si avancë që të*

<sup>35</sup> AMPJ, V. 1920, D. 31, fl.103, Letër e K. Çekrezit drejtuar ministrit të Jashtëm M. Konicës, 17 nëntor 1920.

<sup>36</sup> *Po aty*, fl. 103.

<sup>37</sup> T. Erikson kishte qënë delegat nderi i “Vatrës” në Konferencën e Paqes së Parisit të mbledhur në fund të Luftës së Parë Botërore.

<sup>38</sup> AMPJ, V. 1920, D. 31, fl. 103, Letër e K. Çekrezit drejtuar ministrit të Jashtëm, M. Konica, 17 nëntor 1920.

<sup>39</sup> Ilir Ikonomi, *Faik Konica. Jeta në Uashington*, Tiranë: “Onufri”, 2011, f. 19.

*mund të nis nga puna*”<sup>40</sup>. Këto nuk ishin një luks, por një nevojë pasi situata ndërkombëtare e diskutimit të çështjes shqiptare rëndohej vazhdimisht nga propaganda e shfrenuar antishqiptare e lobit të fuqishëm dhe të mirëorganizuar grek, i cili arriti të bindë Senatën amerikanë “të miratonte rezolutën e senatorëve Loxh-Mose (Lodge-Moses), që propozonte t’i jepej Greqisë Epiri i Veriut, bashkë me Korçën”<sup>41</sup>.

Pavarësisht se njohja nuk u realizua gjatë detyrës së tij, Kostë Çekrezi nëpërmjet kontakteve me Departamentin e Shtetit, me personalitete politike amerikane (nëpërmjet bisedave, letrave, apo memorandumeve), u përpoq shumë për njohjen e qeverisë shqiptare. Ai, duke njohur ndjeshmërinë e popullit amerikan për liri dhe drejtësi, bëri një punë të madhe për informimin dhe sensibilizimin e qeverisë dhe popullit amerikan rreth Shqipërisë, zhvillimeve, problemeve dhe rreziqeve, që e kërcënonin atë qoftë në planin e brendshëm qoftë në atë të jashtëm. Një rrugë mjaft efikase që përdori Çekrezi ishte media. Madje për të përdorur shtypin për të propaganduar çështjen shqiptare ai u bë anëtar i Klubit “National Press”, ku mblidheshin tërë gazetarët dhe ku i jepej mundësia të mbante konferenca shtypi<sup>42</sup>. Të gjitha këto përpjekje ishin një kontribut i konsiderueshëm në funksion të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me SHBA, fakt ky që sipas Çekrezit ishte pohuar dhe nga zoti Robins (Robbins), drejtor i punëve të Ballkanit në Departamentin e Shtetit. Opinioni e këtij të fundit Çekrezi e perifrizonte: *”cilido njeri tjetër që të kish erdhur nuk do të munte kurrë që të bënte atë që kisha bërë unë për të fituar besimin e plotë dhe mirëdashjen e qeverisë amerikane*<sup>43</sup>.

Mosnjohja e Shqipërisë nga amerikanët, dyshimi për stabilitetin e qeverisë, të cilave u shtohej vreri i lobit shovinist kundër Shqipërisë, do t’ia vështirësonin punën kujtdo që do të ishte përfaqësues, pasi e mbanin Amerikën larg Shqipërisë. Nga ana tjetër qeveria amerikane nuk ishte në favor të idesë së dërgimit të një përfaqësuesi amerikan në Tiranë, pasi kjo

<sup>40</sup> AMPJ, V. 1920, D. 31, fl. 17, Raport i K.Çekrezit dërguar ministrit të Jashtëm M. Konicës, 5 mars 1920.

<sup>41</sup> Po aty, fl. 116, Letër e K. Çekrezit drejtuar ministrit të Jashtëm, M. Konica, 19 maj 1920.

<sup>42</sup> Po aty, fl. 29, Letër e K. Çekrezit dërguar ministrit të Jashtëm, M. Konica, 15 mars 1920.

<sup>43</sup> Po aty, fl. 103, Letër e K.Çekrezit dërguar ministrit të Jashtëm, M. Konica, 17 nëntor 1920.

nga shqiptarët mund të konceptohej si njohje zyrtare, ndërkohë që ajo ishte shprehur se duhej pritur akoma. Megjithatë, në dhjetor të vitit 1920 qeveria amerikane dërgoi në Korçë nënkonsullin Robert Tounsed (Robert Townsed). “Prania e Robert Tounsed u vlerësua si një ndihmë për sigurimin e krahinave të Shqipërisë së Jugut”.<sup>44</sup> Në gusht-shtator 1919 ishte shfaqur rreziku i dorëzimit të Korçës tek grekët nga ana e trupave franceze. Çekrezi me aktivitetin e tij pati një farë efekti mbi administratën amerikane, e cila mori vendimin për emërimin e një konsulli amerikan në Korçë. Por, tërheqja e diplomacisë amerikane nga implikimet politike në Evropë ishte një arsye tjetër që ia vështirësonte punën e Çekrezi.

Parë në kontekstin e zhvillimeve ndërkombëtare njohja e pavarësisë së Shqipërisë në kufijtë e vitit 1913, më 9 nëntor 1921 në Konferencën e Ambasadorëve në Paris nga Franca, Anglia, dhe Italia, i bënte kuptimplotë përpjekjet e shqiptarëve për të kërkuar njohjen amerikane. Në janar 1922, F. Noli me autoritetin e ministrit të Jashtëm të Shqipërisë i përcolli Departamentit të Shtetit kërkesën zyrtare të qeverisë shqiptare për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve. Këtë kërkesë Noli e argumentonte me pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve (17 dhjetor 1920), vendimet e Konferencës së Ambasadorëve si dhe me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Anglinë, Francën dhe Italinë<sup>45</sup>. Sukseset e rëndësishme në planin ndërkombëtar ishin një kredo për iniciativën e qeverisë shqiptare për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me ShBA, por edhe shtysë e këtij procesi. Megjithëse Shqipëria ishte anëtare e Lidhjes së Kombeve, Konferenca e Ambasadorëve i ngarkoi Italisë përgjegjësinë për sigurimin e pavarësisë dhe tërësisë territoriale të Shqipërisë. “Noli që nuk mendonte se roli i ri i Italisë ishte në të mirë të interesave të Shqipërisë, e kuptonte se pavarësia e Shqipërisë mund të garantohej nga një fuqi pa ambicie territoriale në rajon”<sup>46</sup>. Ky ishte një motiv i rëndësishëm për të këmbëngulur për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me ShBA. Me autoritetin e ministrit të Jashtëm, ai e emëroi Kostandin Tashkon, konsull të Shqipërisë në Nju Jork, i cili zëvendësoi K. Çekrezin.<sup>47</sup>

<sup>44</sup> B. Meta, *Federata Panshqiptare...*, f. 247.

<sup>45</sup> M. Çami, “Vendosja e marrëdhënieve diplomatike...”, f. 116.

<sup>46</sup> Robert C. Austin, *Shtegu i pashkelur i Nolit*, Tiranë: “Albin”, 2000, f. 50.

<sup>47</sup> M. Çami, “Vendosja e marrëdhënieve diplomatike...”, f. 118.

Në kushtet e problemeve ekonomike që po kalonte bota pas Luftës së Parë Botërore, interesat ekonomike në marrëdhëniet ndërkombëtare merrnin prioritet. Rinjohja e pavarësisë së Shqipërisë pas Luftës së Parë Botërore ishte një garanci, që nxiste kapitalin e huaj të investonte në Shqipëri dhe kjo përkonte me nevojën e vendit, i cili “financiarisht ndodhej akoma në të njëjtën gjendje si pas çlirimit nga sundimi turk”<sup>48</sup>. Më 23 shkurt dhe më pas më 20 mars 1922, amerikani shqiptarofil Erikson, informonte atasheun ushtarak të ambasadës amerikane në Itali, kolonel Donell (Donnelly), se qeveria shqiptare i ishte drejtuar për ndihmë qeverisë britanike. Sipas Eriksonit, qeveria shqiptare kishte kërkuar një ekspert financiar dhe në të njëjtën kohë po përpiqej për të marrë një hua dhe në këmbim ajo premtonte monopolin e naftës për kompaninë “Anglo-Persiane”<sup>49</sup>. Ndërsa për ambasadorin amerikan në Romë, Çajlld (Child), i cili luajti një rol të madh për njohjen e qeverisë shqiptare nga ShBA, vonesa e njohjes rrezikonte interesat amerikane dhe favorizonte ato britanike e italiane nga ato angleze si dhe të tjera.<sup>50</sup>

Interesat ekonomikë të Amerikës ishin kuptuar drejt nga diaspora shqiptare në SHBA dhe miqtë amerikanë, ndaj i shikonin ato si çelësin që do të hapte derën amerikane për Shqipërinë. Në memorandumun e titulluar “Për miqvet mij Buravet të qeveries Shqyptare”, Eriksoni shtronte e trajtonte edhe pyetjen se me cilën mënyrë mund të hyhej në marrëveshje me Amerikën? Përgjigjen ai e gjente tek interesi i kapitalit amerikan për t’i investuar ato jashtë Amerikës, të cilat sipas tij jo vetëm që do ta afronin me shtetin, i cili ishte mbrojtës i këtyre interesave, por dhe do t’i sillte vendit dobi ekonomike<sup>51</sup>. Kjo shtysë e shqiptarëve të Amerikës dhe e miqve amerikanë nuk mund të mos ketë patur ndikim tek qeveria shqiptare “për të joshur” qeverinë amerikane me anë të pasurive natyrore që Shqipëria ofronte. Sipas gazetës “Dielli”: “*Ministri i Punëve të Jashtme i kablloj Komisarit shqiptar në ShBA që profesori Saderholm i Universitetit Helsingfords, një gjeologjist i dëgjuar në Evropë gjeti depozita*

<sup>48</sup> Joseph Swire, *Shqipëria ngritja e një mbretërie*, Tiranë: “Dituria”, 2005, f. 321.

<sup>49</sup> *Foreign Relations of United States of America* (më tej: *FRUS*), Washington, 1922, Vëll. I, Washington, 1938, 594, 875.6363/20, Telegram i ambasadorit amerikan në Itali për Sekretarin e Shtetit, Romë, 3 prill 1922.

<sup>50</sup> Po aty.

<sup>51</sup> *AQSH*, F. 251, V. 1921, D. 97, fl. 1, Memorandum i T. Erikson, “Për miqvet mij Buravet të qeveries Shqyptare”.

platiniumi dhe qymyri në Shqipëri, ku ish dërguar me mision nga Liga e Kombeve (ku SHBA nuk merrte pjesë - M.N.) ...thuhet se mund të barazohen me depozitat e Maleve Urale të Rusisë që gjer sot janë pranuar më të pasurat”<sup>52</sup>. Por, shtypi jo vetëm që evidentonte pasuritë dhe joshite investitorët amerikanë, por përpiquej edhe të nxiste konkurrencën e interesave amerikanë me ato të vendeve të tjera, për ta bërë sa më tërheqëse si rasti në shqyrtim. Dozat e joshjes ishin të tepruara, por të logjikshme në kontekstin e një nevojë të domosdoshme për mbështetjen e SHBA edhe kur qeveria amerikane druhej të merrte iniciativën për njohjen e qeverisë shqiptare<sup>53</sup>. Në aspektin ekonomik Shqipëria po bëhej interesante për to. Sigurimi i të drejtës së koncesioneve të naftës nga amerikanët ishte një problem me rëndësi të madhe për amerikanët. Sekretari i Tregtisë, Herbert Huver (Herbert Hoover), njoftonte Sekretarin e Shtetit se kompania amerikane “Sinkler” ishte shumë e interesuar mbi mundësitë e shfrytëzimit të naftës në Shqipëri dhe se po negocionte të merrte koncesione naftë në Shqipëri<sup>54</sup>. Por, sipas tij e njëjta gjë synohej edhe nga anglezët e italianët, të cilët ishin ndihmuar shumë nga fakti që qeveritë respektive të tyre e kishin njohur Shqipërinë dhe kishin dërguar përfaqësues zyrtarë, që mbështesnin synimet e shtetasve të tyre.<sup>55</sup>

Edhe për zv. presidentin e kompanisë “Sinkler”, Viç (Veatch), interesat amerikanë ishin në një disavantazh të madh në Shqipëri, për shkak të faktit se Shtetet e Bashkuara nuk e kishin njohur Shqipërinë. Lidhur me këtë të fundit, Viç i shkruante Sekretarit të Shtetit, “*Ne fuqishëm rekomandojmë njohjen e Shqipërisë nga SHBA dhe dërgimin e një përfaqësuesi të kësaj qeverie në atë vend*”<sup>56</sup>. Në telegramin dërguar konsullit të Përgjithshëm në Tanxher të Marokut, më 27 prill 1922, Sekretari i Shtetit shkruante se Departamenti i Shtetit po shqyrtonte

<sup>52</sup> “Platinum dhe qymyr në Shqipëri”, Gazeta *Dielli*, Boston, Mass., 31 mars 1922.

<sup>53</sup> Haris Silajxhiç, *Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Uashingtonit*, Tiranë: “Dituria”, 1999, f. 62.

<sup>54</sup> *FRUS*, 1922, V. I, Washington, 1938, 875. 6363/21, f.596, Letër e sekretarit amerikan të Tregtisë, Huver për Sekretarin e Shtetit, Uashington, 26 prill 1922.

<sup>55</sup> *Po aty*.

<sup>56</sup> *Po aty*, 875.6363/22, f. 597, Letër e zv.presidentit të kompanisë “Sinkler” për Sekretarin e Shtetit, Nju Jork, 26 prill 1922.

njohjen e Shqipërisë<sup>57</sup>. Në funksion të kësaj të fundit, zyrtari amerikan me detyrë në Tanxher, Maksuell Blake (Maxwell Blake), ngarkohej të informonte qeverinë amerikane mbi stabilitetin e qeverisë aktuale shqiptare si dhe mbi interesat amerikanë të momentit ose në perspektivë, në atë vend. Departamenti i Shtetit e lidhte njohjen e qeverisë shqiptare me stabilitetin politik në Shqipëri dhe me mundësinë e investimit të kapitalit amerikan në të. Interesi mbi stabilitetin politik në Shqipëri ishte shprehje e politikës amerikane të mospajtimit me ndryshime të dhunshme të qeverive, por edhe shprehje e politikës proteksioniste për kapitalin amerikan, pasi një vend që nuk ka stabilitet politik nuk përbën garanci për investim kapitalesh. Kjo dëshmohet qartë, siç do ta shohim më pas në qëndrimin e qeverisë amerikane ndaj qeverisë noliste më 1924.

Ardhja e Maksuell Blake në Shqipëri ishte bërë e njohur nga Tefik Mborja, përfaqësuesi shqiptar në Romë, i cili në letrën dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme, më 19 maj 1922 shkruante se kishte takuar konsullin Blake, që së shpejti do mbërrinte në Shqipëri si agjent diplomatik me misionin e studimit të gjendjes në Shqipëri. Pasi ta kishte bërë këtë dhe të kishte informuar qeverinë amerikane, kishte të ngjarë të mbetej përfaqësues i saj në Shqipëri<sup>58</sup>. Dërgimi i përfaqësuesit gjysmë zyrtar në Shqipëri ishte gjetje e duhur në kohën e duhur, e cila iu përshtatej interesave të ekonomisë amerikane, tradicionalisht prioritare në politikën e qeverisë amerikane. Presidenti Xh. Uashington përfaqësues i izolacionizmit në “Fjalimin e Lamtumirës” në vitin 1796, shprehej: “Parimi që do të na udhëheqë ne në raport me kombet e huaja është zgjerimi i lidhjeve tregtare...”<sup>59</sup>. Ndërsa presidenti T. Xheferson, po partizan i izolacionit shprehej: “Paqe, tregti, dhe marrëdhënie të ndershme me të gjithë kombet”.<sup>60</sup>

Më 7 qershor 1922, kryeministri shqiptar Xhaferr Ypi njëherazi dhe ministër i Punëve të Jashtme, i dërgoi Departamentit të Shtetit një notë, me anë të së cilës kërkohej vendosja e marrëdhënieve diplomatike<sup>61</sup>.

<sup>57</sup> *Po aty*, 123B 58/175, f.598, Telegram i sekretarit të Shtetit për konsullin amerikan Tanxher, Uashington, 27 prill 1922.

<sup>58</sup> *AQSH*, F. 251, V. 1922, D. 99, fl. 7, Letër e përfaqësuesit shqiptar në Romë, Tefik Mborja, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme, 19 maj 1922.

<sup>59</sup> Michael Cox dhe Doug Stokes, *Politika e jashtme e Shteteve të Bashkuara*, Tiranë: “IDK”, 2008, f. 67.

<sup>60</sup> *Po aty*, f. 67.

<sup>61</sup> M. Çami, “Vendosja e marrëdhënieve diplomatike...”, f. 117.

Nxitëse për këtë të fundit ishte edhe letra e At Gjergj Fishtës e 8 majit 1922 dërguar nga Amerika, ku ai ndodhej në atë kohë. Në këtë letër Fishta duke evidentuar të mirat që vinin nga vendosja e marrëdhënieve diplomatike i propozonte qeverisë shqiptare të kërkonte vendosjen e tyre<sup>62</sup>. Më 10 qershor 1922, tre ditë pas kërkesës për njohjen e shtetit shqiptar nga ana e ShBA, mbërriti në Shqipëri konsulli Maksuell Blake<sup>63</sup>. Kjo kronologji jo rastësore e veprimeve të ndërmarra nga të dyja palët si amerikane ashtu dhe ajo shqiptare në funksion të njohjes së qeverisë shqiptare nga SHBA, dëshmonte se çështja e njohjes kishte marrë rrugë të mbarë.

M. Blake parashtroi dy kërkesa të qeverisë amerikane para se të akordohej njohja e qeverisë shqiptare. Së pari, qeveria shqiptare të jepte një premtim që interesat amerikane do të gëzonin trajtimin e shtetit më të favorizuar. Së dyti, njohja pa konditë nga ana e qeverisë shqiptare si nënshtetas amerikan të të gjithë atyre me origjinë shqiptare, të cilët qenë natyralizuar amerikanë në konformitet me ligjet amerikane<sup>64</sup>. Më 25 qershor 1922 Xhafer Ypi në emër të qeverisë shqiptare pranonte kërkesat e palës amerikane. Në notën e tij kryeministri shqiptar shkruante: *“Pas njohjes zyrtare të qeverisë së Shqipërisë prej asaj të Shteteve të Bashkuar dhe duke pritur bërjen e traktatit tregtar interesat amerikane në Shqipëri do të marrin përdorimin komb më të favorshëm, qeveria është gati t'i krijojë lehtësirat për instalimin e kapitalit amerikan në Shqipëri si dhe t'u japë koncesione shoqërive amerikane”*<sup>65</sup>. Qëndrimi i qeverisë shqiptare ndaj interesave amerikane ishte plotësisht i favorshëm. Kjo shënoi njëkohësisht marrëveshjen e parë shqiptaro-amerikane mbi bazat e së cilës do të përcaktoheshin marrëdhëniet shqiptaro-amerikane në vazhdimësi.

Pas shqyrtimit të kujdesshëm të situatës në Shqipëri, bazuar mbi një informacion të gjerë mbi vendin dhe njerëzit, më 28 qershor 1922, M.

<sup>62</sup> Po aty.

<sup>63</sup> Po aty, f. 118.

<sup>64</sup> AMPJ, V. 1922, D. 99, fl. 8, Letër e komisarit të Shteteve të Bashkuara në Tiranë, Maxwell Blake, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme, 23 qershor 1922; po aty, V. 1925, D. 129, fl.1, Relacion i MPJ mbi marrëdhëniet shqiptaro-amerikane.

<sup>65</sup> Po aty, V. 1922, D. 99, fl. 11, Letër e kryeministrit Xhaferr Ypi drejtuar konsullit Maxwell Blake, 25 qershor 1922; po aty, V. 1925, D. 129, fl. 1, Relacion i MPJ.

Blake në telegramin drejtuar Sekretarit të Shtetit rekomandonte njohjen e Shqipërisë<sup>66</sup>. Më 28 korrik 1922, ai informoi kryeministrin Ypi se qeveria amerikane duke marrë në konsideratë vazhdimësinë e suksesshme të qeverisë shqiptare, ofronte njohjen “de jure” të qeverisë së kryesuar prej tij<sup>67</sup>. Në pritje të përfaqësuesit të rregullt diplomatik qeveria amerikane ngarkoi zotin Blake të vepronte si komisioner i SHBA në Shqipëri<sup>68</sup>. Pak kohë më pas qeveria amerikane emëroi përfaqësuesin e saj zyrtar në Shqipëri, diplomatit e karrierës U. Grant Smith.

Grant-Smith (Grant-Smith) i lindur më 18 nëntor 1870 në Pensilvani dhe i arsimuar në Harvard, vinte në Shqipëri pas një karriere të gjatë diplomatike si sekretar, këshilltar dhe si i Ngarkuar me Punë, në legatat dhe ambasadat amerikane në një sërë vendesh si Londër, Bruksel, Vjenë, Kopenhagen, dhe së fundmi në Hungari<sup>69</sup>.

Më 4 dhjetor 1922, Grant-Smith në fjalën e tij prezantuese gjatë dorëzimit të kredencialeve pranë Këshillit të Lartë të Regjencës dhe kryeministrit njoftoi se ishte ngarkuar prej kryetarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës U. Harding (Warren Harding), t’u dorëzonte letrën, e cila e akreditonte të dërguar të jashtëzakonshëm dhe ministër të Plotfuqishëm të SHBA në Shqipëri<sup>70</sup>.

Njohja e qeverisë shqiptare nga SHBA dhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike me të shënonin një ngjarje të madhe për Shqipërinë dhe popullin shqiptar. Për këtë kontribuan shumë faktorë të cilët meritojnë respekt, vlerësim dhe mirënjohje. Në dokumentet e Departamentit të Shtetit në favor të njohjes së Shqipërisë, krahas të dhënave që populli shqiptar ishte premtues në Ballkan, si faktor i rëndësishëm primare veçohet diaspora shqiptare në Amerikë<sup>71</sup>.

<sup>66</sup> *FRUS*, 1922, V. I, Washington, 1938, 875.01/215, f. 602, Telegram i komisionerit amerikan në Shqipëri, Blek (Blake), për Sekretarin e Shtetit, Tiranë, 28 qershor 1922.

<sup>67</sup> *AMPJ*, V. 1922, D. 99, fl. 16, Letër e komisarit të Shteteve të Bashkuara në Tiranë, Maxwell Blake, dërguar kryeministrit shqiptar, 28 korrik 1922.

<sup>68</sup> *FRUS*, 1922, V. I, Washington, 1938, 875,01/223a, f. 604, Telegram i Sekretarit të Shtetit për komisionerin amerikan në Shqipëri, Blek, Uashington, 25 korrik 1922.

<sup>69</sup> *AMPJ*, V. 1922, D. 99, fl. 30, Biography of Hon. Ulysses Grant Smith.

<sup>70</sup> *Po aty*, fl. 17, Fjala e U. Grant Smith në Tiranë, 4 dhjetor 1922.

<sup>71</sup> H. Silajxhiç, *Shqipëria dhe SHBA...*, f. 156.

Historiografia shqiptare ka vlerësuar rolin e diasporës shqiptare dhe veçanërisht “Vatrës”, në këtë proces. Ishin shqiptarët e Amerikës, të grupuar rreth Federatës “Vatra” dhe “Partisë Politike”, të cilët ditën të orientonin Shqipërinë drejt shtetit të duhur dhe në kohën e duhur. Madje ato pavarësisht mosmarrëveshjeve midis tyre, thirrjes së delegacionit shqiptar në Paris për të kërkuar mbështetjen amerikane iu përgjigjën me veprime të bashkërenduara. Ato arritën një akord bashkëpunimi, i cili parashtronte dhe aktivitetin e gjithanshëm për sigurimin e mbështetjes së ShBA, si përpjekje pranë qeverisë amerikane dhe delegacionit amerikan në Konferencën e Paqes, takime me personalitete politike amerikane, bashkëpunim me shtypin, etj.<sup>72</sup> Ishte “Vatra” ajo që i ofroi shtetit shqiptar idenë e një përfaqësuesi zyrtar, madje dhe financoi për mbajtjen e tij. Ishte po “Vatra”, ajo që nëpërmjet delegatit të saj të nderit T. Erikson i ofroi qeverisë shqiptare, idetë, modelet dhe perspektivën për prosperitet. Të gjitha këto në funksion të orientimit të shtetit shqiptar drejt kësaj fuqie mjaft të rëndësishme për fatet e vendit<sup>73</sup>. Kjo ishte zgjedhje e mençur e “Vatrës” pasi Eriksoni duke qenë se ishte amerikan i informuar për Shqipërinë, informacionet e tij “mirëbesoheshin nga ambasadori amerikan në Romë”<sup>74</sup>, eksponent ky i angazhuar në çështjen e njohjes së Shqipërisë. Gjithashtu pas Luftës së Vlorës, përpjekjeve të Çekrezit për njohjen e qeverisë shqiptare do t’u shtohen edhe ato të “Vatrës”. Kjo e fundit nëpërmjet mitingjeve dhe memorandumeve kërkonte me insistim njohjen e qeverisë shqiptare nga ShBA<sup>75</sup>. “Vatra” në funksion të sigurimit të ndihmës në propagandimin e çështjes shqiptare u përpoq të bashkëpunonte me Kishën Methodiste Episkopale, besimtarët e së cilës përbënin 1/3 e popullsisë së ShBA<sup>76</sup>. Lidhur me rolin e kësaj kishe, Çekrezi në letrën dërguar M. Konicës më 27 mars 1920, do të shprehej: “...se sa i madh do të jetë fitimi për ne nga një lidhje e tillë me ata që kanë veglat më të forta për të përhapur një propagandë të madhe

<sup>72</sup> B. Meta, *Federata Panshqiptare...*, f. 248.

<sup>73</sup> *AQSH*, F. 251, V. 1921, D. 97, fl. 1, Memorandum i T. Erikson, “Për miqvet mij Buravet të qeveries Shqyptare”.

<sup>74</sup> *FRUS*, 1922, V. I, Washington, 1938, 875.6363/20, f.594, Telegram i ambasadorit në Itali (Child) dërguar Sekretarit të Shtetit, Romë, 3 prill 1922.

<sup>75</sup> B. Meta, *Federata Panshqiptare...*, f. 268.

<sup>76</sup> *Po aty*, f. 255.

*simpatie për Shqipërinë këtu në Amerikë është gjë që e kuptoni vetë*<sup>77</sup>. Por përpjekjet e “Vatrës” dhe të Çekrezit mbetën vetëm të tilla, pasi nuk patën rezultat në këtë marrëdhënie<sup>78</sup>. Duke njohur mirë realitetin amerikan “Vatra” veproi dhe kontribuoi me maturi dhe mençuri.

Shqipëria nuk u përfaqësua menjëherë në kryeqytetin amerikan. Në gusht 1922, si ministër Fuqiplotë në Uashington u propozua Mit’hat Frashëri, por në janar të 1923 Ministria e Punëve të Jashtme vendosi ta shtyjë për një afat të pacaktuar emërimin e tij<sup>79</sup>. Arsyet e mospërfaqësimit të Shqipërisë në kryeqytetin amerikan lidheshin me krizën politike dhe ekonomike që përjetonte vendi. Një tjetër arsye ishte edhe fakti që, vëmendja kryesore e qeverive shqiptare ishte përqendruar në Londër, si qendër e diplomacisë evropiane për kohën, pas tërheqjes së SHBA nga vendimmarrja politike për çështjet evropiane. Nga ana tjetër, Britania e Madhe ishte një anëtare e fuqishme e Lidhjes së Kombeve ndërkohë që SHBA nuk bënin pjesë në të. Por kishte edhe një arsye të tretë. Më 6 prill 1924, dy qytetarë amerikanë G.B. De Long (G.B. De Long) dhe R.L. Koleman (R.L. Coleman), të cilët kishin ardhur si turistë, u vranë gjatë udhëtimit të tyre nga Tirana për në Shkodër<sup>80</sup>. Përfaqësuesi amerikan, Grant Smith, në takimin me ministrin e Punëve të Jashtme I. Vrioni, më 14 prill 1924, i kishte lënë të kuptonte këtij të fundit se nuk do të kishte asnjë masë ose protestim. Por, nga ana tjetër qeveria e Uashingtonit do të ndiqte me shumë vëmendje vullnetin që do të tregonte qeveria shqiptare në kapjen dhe dënimin e vrasësve<sup>81</sup>. Për mbylljen e çështjes njëherë e përgjithmonë, ministri i Jashtëm Vrioni insistoi në vazhdimin e kërkimeve për të gjetur shkaktarët e krimit dhe dënimin e rreptë të tyre pasi “për amerikanët nxjerrja në shesh e qëllimit të kësaj vrasje ishte pika kryesore”<sup>82</sup>. Qeveria shqiptare shpalli gjendjen e jashtëzakonshme, bëri arrestime, krijoi një gjykatë speciale, por përgjegjësit e vërtetë nuk u

<sup>77</sup> AMPJ, V. 1920, D. 31, fl. 43, Letër e Çekrezit dërguar M. Konicës, 27 mars 1920.

<sup>78</sup> B. Meta, *Federata Panshqiptare...*, f. 255.

<sup>79</sup> I. Ikonomi, *Faik Konica...*, f. 21-22.

<sup>80</sup> AMPJ, V. 1924, D. 17, fl. 26, Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë dërguar legatave shqiptare, 9 prill 1924.

<sup>81</sup> *Po aty*, fl. 31, Shkresë “Mbi vrasjen e dy amerikanëve” e ministrit të Punëve të Jashtme, I. Vrioni, dërguar ministrit të Punëve të Brendshme, Sh. Vërlaci, 15 prill 1924.

<sup>82</sup> *Po aty*.

gjendën. Çështja e vrasjes së dy amerikanëve ishte një ngërç në mbarëvajtjen e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane si dhe pjesë e qëndrimeve të qeverisë amerikane në zhvillimet e mëtejshme politike në Shqipëri. Vrasja e amerikanëve ndikoi në rritjen e tensionit dhe acarimin e situatës, e cila u përkeqësua edhe nga plagosja e Avni Rustemit, vdekjen e së cilës opozita e përdori si pretekst për rrëzimin e qeverisë.

Pas ardhjes në pushtet, F. Noli në vizitat e tij në legatën amerikane, më 22 qershor 1924 dhe më pas në fillim të korrikut 1924, shtroi kërkesën për njohje nga qeveria e SHBA, e cila u dëgjua me mirëdashje<sup>83</sup>. Me premtimet e tij për një politikë “të matur” si dhe me programin prej 20 pikash, i cili përvijonte një Shqipëri me fytyrë dhe përmbajtje demokratike, ai synoi të krijonte tek përfaqësuesi amerikan një imazh të mirë për qeverinë e tij. Nga ana tjetër, përfaqësuesi amerikan Grant-Smith i bëri të ditur Nolit se qeveria e tij i shmangej marrjes së vendimeve të shpejta për njohje qeverish. Gjithashtu Grant-Smith përmendi edhe faktin se qeveria pararendëse nuk kishte përmbushur premtimet lidhur me interesat ekonomike amerikane dhe nuk kishte zgjidhur çështjen e vrasjes së dy amerikanëve<sup>84</sup>. Uashingtoni nuk ishte i kënaqur nga A. Zogu, i cili koncesionet vajguore ia kishte njohur si monopol shoqërisë angleze “Anglo-Persiane” në dëm të shoqërisë amerikane “Standart Oil”. Gjithashtu Uashingtoni nuk ishte i kënaqur sepse nuk ishin zbuluar dhe dënuar vrasësit e dy amerikanëve në prill 1924<sup>85</sup>. Grant-Smith i kërkoi Nolit që qeveria e tij të angazhohej zyrtarisht se do t’i plotësonte këto dy çështje<sup>86</sup>. Përfaqësuesi amerikan shikonte tek qeveria e Nolit prirje proamerikane dhe shpresonte se ajo do të ndryshonte klimën jo të mirë të krijuar nga mosplotësimi i dy çështjeve të sipërpërmendura nga regjimi i mëparshëm.

Në mungesë të legjitimitetit të buruar nga votëbesimi në parlament ose nga zgjedhjet e reja, Smithi sipas instruksioneve të Departamentit të Shtetit mbajti marrëdhënie me qeverinë e re, por pa i kompromentuar ato si njohje<sup>87</sup>. Amerikanët duke mos vënë në diskutim çështjen e njohjes i dhanë një shans Nolit, për ta ligjësuar pushtetin e tij. Gjithashtu qeveria e Nolit me anë të konsullit të Shqipërisë në Nju Jork, Abdyl Sula, “ i cili

<sup>83</sup> A. Puto, *Shqipëria Politike ...*, f. 373.

<sup>84</sup> H. Silajxhiç, *Shqipëria dhe SHBA...*, f. 154.

<sup>85</sup> A. Puto, *Shqipëria Politike...*, f. 373.

<sup>86</sup> H. Silajxhiç, *Shqipëria dhe SHBA...*, f. 154.

<sup>87</sup> R. C. Austin, *Shtegu i pashkelur...*, f. 173.

zëvendësoi Kostandin Tashkon,<sup>88</sup> u interesua për mundësinë e hapjes së legatës shqiptare pranë Departamentit të Shtetit, por qeveria noli të nuk pati kohë për të<sup>89</sup>.

Ndërkohë qeveria e Nolit deklaroi se, fajtorët për vrasjen e dy amerikanëve më 6 prill 1924, do të ndëshkoheshin. Ndërsa fakti që anëtarë të qeverisë e të Parlamentit ishin ish opozitarët në parlamentin e vitit 1923, të cilët kishin kundërshtuar ratifikimin e koncesioneve të kompanisë “Anglo-Persiane” përballë ofertës amerikane, aludonte siguri për respektimin e interesave ekonomike amerikane. Konsulli amerikan në Firence, Xhozef Heiven (Joseph Hawen), shihte tek Noli “*admiruesin e sinqertë të Amerikës dhe që mendonte se koncesionet u duheshin dhënë kompanive amerikane dhe veçanërisht Sinklerit*”<sup>90</sup>. Por qeveria pa bazë ligjore e Nolit nuk përbënte asnjë garanci për shtetin amerikan.

Pas 6 muajsh jetë qeveria e Nolit, e cila nuk gjeti mbështetje ndërkombëtare, u rrëzua nga rikthimi në pushtet i A. Zogut. Më 20 janar 1925, Sekretari i Shtetit, Hjuze (Hughes), i shtyrë nga pohimi i Smithit se qeveria ishte e qëndrueshme si dhe nga fakti se fqinjët dhe fuqitë europiane nuk e kishin kundërshtuar qeverinë e re, njoftoi Smithin se nëse merrte siguri nga Zogu për kërkimin e përgjegjësve të vrasjes së dy amerikanëve, Departamenti i Shtetit do të jepte pëlqimin për njohjen<sup>91</sup>. Ministri amerikan pasi mori sigurinë e qeverisë shqiptare për gjetjen e vrasësve të dy amerikanëve, më 30 janar 1925 informoi Sekretarin e Shtetit Hjuze. Ky i fundit, më 31 janar 1925, e autorizoi Grant-Smithin të njihte regjimin e ri<sup>92</sup>.

Zogu ndoqi një politikë të jashtme rajonale duke u fokusuar tek fqinjët tokësorë, por ai ishte i prirur dhe për bashkëpunim me Fuqitë e Mëdha. Këtë diplomaci Zogu ia kushtëzonin një sërë faktorësh që lidheshin ngushtë me njëri-tjetrin si, pozita gjeografike, armiqësitë e vjetra, urrejtjet dhe lakmitë e frikshme dhe pa kufi të fqinjëve, rivaliteti i Fuqive të Mëdha dhe mungesa e një fuqie historikisht mbrojtëse të Shqipërisë. Kjo diplomaci e zhdërvjellët e A.Zogut justifikon iniciativën

<sup>88</sup> Uran Asllani, *Diplomacia dhe diplomatët shqiptarë 1912-1944*, Tiranë: “Ilar”, 2006, f. 331.

<sup>89</sup> I. Ikononi, *Faik Konica...*, f. 22.

<sup>90</sup> *Po aty*, f. 177.

<sup>91</sup> R. C. Austin, *Shtegu i pashkelur...*, f. 212.

<sup>92</sup> Leonard Demi, *Shqipëria dhe Diplomacia Amerikane*, Tiranë: “Guttenberg”, 2009, f. 23.

e tij për t'iu drejtuar ShBA për hapjen e një legate shqiptare, ide e hershme kjo e propozuar nga K. Çekrezi.

Bashkë me këmbënguljen për hapjen e legates, Zogu zgjodhi edhe përfaqësuesin e tij në Uashington, Faik Konicën. Po çfarë e shtyu A. Zogun që të bënte këtë zgjedhje? Konica ishte një eksponent i rëndësishëm i “Vatrës” si në kuptimin e kontributit që ai kishte dhënë në formimin e saj, ashtu dhe në kuptimin e posteve dhe përgjegjësisë të vazhdueshme që ai kishte mbajtur në Federatë. Fjalimet e zjarra të mbajtura në mitingjet e tetor-dhjetorit 1909 në funksion të bashkimit të shoqërive shqiptare në Amerikë, dhe detyra e hartimit të projektit të plotë të Kanunores (së bashku me Kristo Floqin), mbi parimet e së cilës do të ngrihej dhe funksiononte shoqëria e re<sup>93</sup> ishin një kontribut i konsiderueshëm i Konicës në formimin e “Vatrës”. Pas një qëndrimi tetëvjeçar në Europë F.Konica i ftuar nga Kuvendi i “Vatrës”, më 1921, erdhi në krye të saj.<sup>94</sup> Duke qenë një nga figurat kryesore të “Vatrës” ai ngarkohet nga kjo e fundit me detyra në dobi të Lëvizjes Kombëtare. F.Konica u dërgua nga “Vatra” në Evropë për të ndjekur nga afër punimet e Konferencës së Ambasadorëve të mbledhur në Londër më 17 dhjetor 1912, mori pjesë në Kongresin e Triestes në mars të 1913 dhe në ceremoninë për pritjen e Vidit në Durrës më 1914<sup>95</sup>. Gjithashtu, ai ishte një nga delegatët e nderit të “Vatrës” në Konferencën e Paqes së pas Luftës së Parë Botërore<sup>96</sup>. Veprimtaria e F.Konicës në dobi të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare para dhe pas krijimit të “Vatrës” si dhe postet drejtuese të mbajtura prej tij në Federatë i dhanë atij një reputacion të madh. Me sa duket kjo ishte një nga arsyet e zgjedhjes së Konicës për të përfaqësuar Shqipërinë në ShBA. Duke qenë një eksponent i rëndësishëm i “Vatrës”, së fundmi (deri në emërimin e tij përfaqësues i legatës shqiptare në SHBA), drejtues i saj prej 5-vitesh, ai kishte një influencë të madhe mbi “Vatrën” dhe vatanët. Në një shënim të Sektorit për Çështjet e Lindjes së Afërme shkruhej: “Dëshira e presidentit shqiptar për të emëruar Konicën si ministër në Shtetet e Bashkuara ka shumë mundësi të jetë një përpjekje për të siguruar mbështetjen politike të Shoqërisë

<sup>93</sup> B. Meta, *Federata Panshqiptare...*, f. 22-25.

<sup>94</sup> Valentina Duka, *Çështje të historisë bashkëkohore të shqiptarëve*, Tiranë: “SHBLU”, 2008, f. 129.

<sup>95</sup> *Po aty*, f. 86-129.

<sup>96</sup> B. Meta, *Federata Panshqiptare...*, f. 207.

“Vatra”<sup>97</sup>. Nisur nga potenciali dhe reputacioni i “Vatrës” dhe nevojës së Zogut për mbështetjen e saj, ka gjasa që sigurimi i kësaj të fundit ta ketë shtyrë më së tepërmi Zogun në zgjedhjen e tij për Konicën.

Reputacioni që gëzonte Faik Konica tek amerikanët si person pro amerikan, i mirëarsimuar dhe patriot e bënte atë një kandidaturë të pranueshme për amerikanët. Kjo ishte një arsye tjetër që ndikoi në zgjedhjen e tij prej Ahmet Zogut, si përfaqësues i Shqipërisë në SHBA.

Më 5 prill 1926, Sekretari i Shtetit F.Kellog (Frank Kellogg), informoi presidentin e SHBA, Kullixh (Calvin Coolidge), se presidenti i Shqipërisë, A. Zogu, dëshironte të hapte legatë në Uashington dhe të emëronte Faik Bej Konicën si autoritet përfaqësues. Presidenti Kullixh mbi letrën e Sekretarit të Shtetit F.Kellog, shkroi: “U bë. Le të vijë”<sup>98</sup>. Më 8 tetor 1926, Faik Konica i paraqiti letrat kredenciale presidentit Kullixh në Shtëpinë e Bardhë, në të cilat presidenti i Republikës së Shqipërisë e emëronte të dërguar të Jashtëzakonshëm dhe ministër Fuqiplotë në Shtetet e Bashkuara<sup>99</sup>.

Në fjalën e mbajtur gjatë ceremonies, Faik Konica vuri në dukje respektin dhe mirënjohjen e popullit shqiptar ndaj Amerikës dhe shprehte angazhimin e tij në forcimin e mëtejshëm të miqësisë midis dy vendeve. Presidenti amerikan vlerësoi komentin e F. Konicës për ndjenjat proamerikane të popullit shqiptar dhe e uroi për misionin<sup>100</sup>. Dëshira për hapjen e legatës shqiptare në Uashington u bë realitet. Prania e legatës shqiptare në SHBA ishte një imazh pozitiv për Shqipërinë, por ajo që ishte më e rëndësishme ishte dobia e saj në funksion të interesave kombëtarë si dhe të marrëdhënieve shqiptaro-amerikane.

---

<sup>97</sup> I. Ikonimi, *Faik Konica...*, f. 12.

<sup>98</sup> *Po aty*, f. 8.

<sup>99</sup> *Po aty*, f. 36.

<sup>100</sup> *Po aty*, f. 37.

*S u m m a r y*

AN ANALYTIC OVERVIEW OF THE PROCESS OF ESTABLISHING  
THE DIPLOMATIC RELATIONS BETWEEN ALBANIA  
AND THE UNITED STATES OF AMERICA  
(1922-1926)

The Albanian-American relations were strongly based on a historical affinity which dates back to the arrival of the first Albanian emigrants to the USA at the end of the 19<sup>th</sup> century. From this experience the Albanian diaspora understood the sense, power and international position of the USA, and was made aware of the importance that this Great Power had for the fate of its mother country.

Albania had constantly attracted the attention of the Great Powers with its strategic geographic position and its natural resources. This had also incited the greed of its Balkan neighbors, a fact that had become more obvious during the First World War. The threat of losing Albania's independence and/or parts of its territory made Albanians to need and seek the US support more than ever before considering that this Power had not been involved in the Secret Treaty of London. The American attitude towards this issue resulted crucial for the fate of Albanians and at the same time gave hope for the establishment of good diplomatic relations between the two countries once history would offer the appropriate time for it.

The economic interests that the US had in Albania, the endeavors of the Albanian government and moreover those of the diaspora across the Atlantic, all this intertwined with the American idealism led to the recognition of the Albanian government and the establishment of the diplomatic relations between Albania and the US in 1922. In this context, the first US Minister in Albania, U. Grant-Smith, arrived in December 1922. The process of developing diplomatic relations between the two countries ended in 1926, due to a lack of political and financial stability in Albania, with the opening of the Albanian consulate in America headed by Faik Konica.

